



Pranuar / Dorezuar Punë/Pradato Received/Delivered	01.04	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Br Prot Br Prot Prot No	Shitja e Protog Appendix	Sasia Kohësira Quantity	
SKPMSTK	1789	/2022	119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS

A.nr.170/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca -anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 170/2022 të datës 25.02.2022 të parashtruar nga ankuesit dhe

Nikoliq, të cilët i përfaqëson me autorizim avokate

½ , Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.04.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.170/2022 e datës 25.02.2022 e parashtruar nga grup ankuesist dhe

A r s y e t i m

Ankuesit nëpunës civilë në Ministrinë Financave Punës dhe Transfereve, nëpërmjet përfaqësueses së tyre me autorizim më datë 25.02.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve për mos zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtës ditore dhe pagës jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli), më datë 03.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje

në ankesë të ankuesve të organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 22.03.2022, ka dëgjuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1001/2022 të datës 25.02.2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Fletë dërgesën e datës 10.02.2022; Kërkesën e datës 09.02.2022; Njoftimin me numër 603 të datës 22.12.2021; Autorizimet e datës 21.04.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1144/2022 të datës 03.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1486/2022 të datës 22.03.2022; Emalin e datës 09.03.2022; Dëshmimi lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për periudhën 01.08.2017-31.08.2017 për ankuesir Akt-in e emërimit të datës 01.01.2012 të ankuesit Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1543/2022 të datës 23.03.2022; Kërkesën me numër 154 të datës 16.02.2022; Listën e pagave për periudhën kohore 01.11.2018-30.11.2018 me të cilën dëshmohet se ankueses i është bërë kompensimi jubile; Listën e pagave për periudhën kohore 01.09.2017-30.09.2017 me të cilën dëshmohet se ankuesit është bërë kompensimi jubilarë; Lista e pagave për periudhën kohore 01.09.2017-30.09.2017 me të cilën dëshmohet se ankuesit i është bërë kompensimi jubilarë; Lista e pagave për periudhën kohore 01.10.2017-31.10.2017 me të cilën dëshmohet se ankueses i është bërë kompensimi i jubilarë; Vendimin e datës 30.09.2021 me të cilin dëshmohet se ankuesja i është përfunduar madheni e punës për shkak të arritjes së moshës për pensionim; Dëshmi e lidhur me pagesën, e pagës përcjellëse me rastin e pensionimit të ankueses Emalin e datës 29.03.2022; Akt emërimit me numër të protokollit 117 të datës 28.12.2017 të nëpunëses civil Aktin e emërimit me numër të protokollit 109 të datës 28.12.2017 të nëpunësit civil Akt emërimit me numër të protokollit 112 të datës 28.12.2017; Akt Emërimit me numër të protokollit 106 të datës 28.12.2017 të nëpunësit civil Njoftimet e datës 22.02.2022 lidhur me kërkesën e adresuar gabimisht;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi së ankesa e ankuesve është *e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 01.01.2012 është i punësuar në Ministrinë e Punës tani Ministria e Financave, Punës dhe Transferove, në pozitën *Nëpunës i Pensioneve dhe Beneficioneve*, Zyra e Punësimit në Gjilan, ankuesja sipas Akt emërimit me numër protokollit APRK 112 të datës 28.12.2017 është i punësuar në Agjencinë e Punësimit në pozitën *Zyrtare e Punësimit*, Zyra e Punësimit në Gjilan, ankuesja sipas Akt emërimit me numër protokollit APRK 117 të datës 28.12.2017 është e punësuar në Agjencinë e Punësimit në pozitën *Zyrtare për Shërbim të Punësimit*, Zyra e Punësimit në Gjilan, ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokollit APRK 109 të datës 28.12.2017, është i punësuar në Agjencinë e Punësimit në pozitën *Zyrtar për Shërbim të Punësimit*, Zyra e Punësimit në Gjilan, dhe ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokollit APRK 106 të datës 28.12.2017 është i punësuar në Agjencinë e Punësimit në pozitën *Udhëheqës i Zyrës së Punësimit*, Zyra e Punësimit në Gjilan.

Ankuesit me datë 10.02.2022 përmes përfaqësuesit të tyre më autorizim kanë parashtruar kërkesë tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për kompensimin e pagës jubilarë dhe shujtës ditore për periudhën nga data 09.02.2016 deri me 09.02.2022. Ndërsa me datë 22.02.2022, Njësia e Personelit të

Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, nuk ofron përgjigje për ankuesit përveç shënimit në kërkesën e ankuesve se *kërkesa e ankuesve është adresuar gabimisht*, pas këtij njoftimi ankuesit më datë 25.02.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve për mos zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtës ditore dhe pagës jubilarë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës, ka konstatuar se ankuesit _____ i është kompensuar shpërblimi jubilar në muajin gusht 2017, ndërsa ankuesve _____ dhe _____ kompensimi jubilar i'u është bërë në muajin gusht 2018, dhe për ankuesit _____ dhe _____

_____ kompensimi i pagës jubilarë i'u është bërë në muajin shtator 2017, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se organi i punësimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)"* si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune"*.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve së Ministria e Financave Punës dhe Transfereve nuk respekton Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e shujtave dhe pagave jubilarë sipas nenit 52, 53 dhe 54 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, Kolegji ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive pas datës 31.12.2017, andaj mbi këtë bazë, pretendimi ankimor i ankuesve është i pabazuar ngase për të punësuarit në shërbimin civil e vetmja formë për kompensimin e shpërblimit të përvjetorit (jubile) është ajo e përcaktuar me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe me nenin 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:


Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje



Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr.170/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueseve avokates [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

